



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA | REPUBLIC OF KOSOVO  
AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT  
AGENCIJA ZA SPREČAVANJE KORUPCIJE  
AGENCY FOR PREVENTION OF CORRUPTION



AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT  
AGENCIJA ZA SPREČAVANJE KORUPCIJE  
AGENCY FOR PREVENTION OF CORRUPTION

DATË/A:	20.03.2023	06/02	704/23
REFERENC-Ë:	AKK-DPKI-06-216/23	012	06.04.2023
PËR/ZA/TO:	- Këshilli Drejtues i Institutit të Historisë "Ali Hadri" në Prishtinë; - Këshilli Shkencor i Institutit të Historisë "Ali Hadri" në Prishtinë; - znj. Teuta SHALA - PELI, u.d. Drejtoreshë e Institutit të Historisë "Ali Hadri" në Prishtinë; - z. Bejtullah DESTANI, (ish) anëtar i Këshillit Drejtues të Institutit të Historisë "Ali Hadri" në Prishtinë		
CC:	- znj. Arbërie NAGAVCI, Ministre e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit		
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z. Yll BULESHKAJ, Drejtor i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit		
NGA/OD/FROM:	Esad EJUPI, Drejtor i Departamentit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit		
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me shqyrtimin e konfliktit të interesit në Institutin e Historisë "Ali Hadri" në Prishtinë		

Të nderuar/a,

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (në vijim: Agjencia), pas informatave të pranuar nga jashtë me dyshimin për konflikt të interesit lidhur me disa procese në Institutin e Historisë "Ali Hadri" në Prishtinë (në vijim: Instituti i Historisë), konform kompetencave të saj të përcaktuara me dispozitat e Ligjit nr. 06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (në vijim: LPKI), në cilësinë e autoritetit qendror për mbikëqyrjen dhe zbatimin e dispozitave të këtij ligji, në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pika 1.1.1, të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit dhe nenit 21, paragrafi 1, nënparagrafët 1.4, 1.5, 1.7 dhe paragrafi 2, të LPKI-së, nxjerrë këtë:

### OPINION

Është konstatuar se në kuptim të dispozitave të LPKI-së, nuk ka prova të mjaftueshme që argumentojnë dyshimet për ekzistimin e konfliktit të interesit lidhur me procesin e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së zyrtares së lartë znj. Teuta Shala - Peli, u.d. Drejtoreshë e Institutit të Historisë, procesin e konkursit (aktual) për zgjedhjen e drejtorit të Institutit të Historisë dhe procesin e trajtimit të kërkesës për mbështetje të botimit të librit të z. Bejtullah Destani.

1/12

## A r s y e t i m

Agjencia ka pranuar disa raportime nga jashtë (raportuesi i rastit), me dyshimin për konflikt të interesit në lidhje me disa procese në Institutin e Historisë. Përveç kësaj, raportuesi i rastit në vazhdimësi ka paraqitur në Agjenci kërkesa, informata dhe dokumentacion në lidhje me këtë rast, si dhe i njëjti pretendimet e tij i ka paraqitur edhe në takimin e mbajtur në Agjenci më datë 14.02.2023. Poashtu, në lidhje me këtë rast Agjencia ka pranuar edhe një raportim anonim.

Në shkresat me informata dhe dokumentacion të parashtruara në Agjenci, të cilat shihet se janë deponuar edhe tek mekanizma dhe institucione tjera nga raportuesit e rastit, përveç pretendimeve për konflikt të interesit, janë ngritur edhe pretendime tjera lidhur me (pa)rregullsinë e proceseve për zgjedhjen e (u.d.) drejtorit të Institutit të Historisë, mandej pretendime për shkeljen e dispozitave dhe procedurave të brendshme të përcaktuara me legjislacionin për Institutin e Historisë, pretendime për mandatin e anëtarëve të Këshillit Drejtues (KD) të Institutit të Historisë, pretendime për keqpërdorim të detyrës zyrtare, si dhe shumë pretendime tjera jashtë sferës së konfliktit të interesit.

Mirëpo, Agjencia konform mandatit dhe kompetencave ligjore që ka sipas Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, ka zhvilluar hetimin administrativ duke trajtuar dhe shqyrtuar vetëm pretendimet për konflikt të interesit në kuptim dispozitave të LPKI-së.

Kështu, nga shkresat me informata dhe dokumentacion të pranuar nga raportuesit e rastit dhe takimi me raportuesin e rastit, dalin kërkesat për hetim dhe trajtim nëse paraqesin konflikt të interesit situatat si në vijim: *procesi i zgjedhjes dhe rizgjedhjes së zyrtares së lartë znj. Teuta Shala - Peli, u.d. Drejtoreshë e Institutit të Historisë, procesi i konkursit (aktual) për zgjedhjen e drejtorit të Institutit të Historisë, si dhe procesi i trajtimit të kërkesës për mbështetje të botimit të librit të z. Bejtullah Destani, (ish) anëtar i KD të Institutit të Historisë, nga Këshilli Shkencor (KSH) i këtij instituti.*

Agjencia përmes shkresës zyrtare (DPKI-06-02/262/23), ka njoftuar zyrtaren e lartë z. Teuta Shala - Peli, lidhur me fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së konfliktit të interesit. Pas kësaj, është organizuar dhe mbajtur një takim me zyrtaren e lartë në Agjenci, me ç'rast e njëjta është njoftuar me pretendimet për konflikt të interesit dhe faktet që posedon Agjencia lidhur me këtë rast.

Zyrtarja e lartë znj. Teuta Shala - Peli, në takimin e mbajtur dhe përmes shkresave sqaruese e dokumentacionit të dorëzuar në Agjenci (DPKI-06-02/262-1/23), ka paraqitur qëndrimet dhe argumentet e saj për secilin pretendim të ngritur për konflikt të interesit, duke paraqitur edhe prova të shkruara përkritazi me deklaratimet dhe sqarimet e saj. Zyrtarja në fjalë, në takimin e mbajtur ndër të tjera ka theksuar se nuk konsideron se ka shkaktuar konflikt të interesit në asnjërin nga proceset për të cilat është pretenduar nga raportuesit e rastit, sepse në të gjitha rastet ka ushtruar funksionin e saj konform ligjit dhe akteve tjera normative të Institutit të Historisë, është tërhequr nga vendimmarrja në proceset që ka pasur konflikt të interesit dhe është zëvendësuar konform akteve normative të Institutit të Historisë, dhe se në çdo rast është marrë edhe interpretimi i sekretarit të këtij instituti.

Gjithashtu, Agjencia ka njoftuar edhe z. Bejtullah Destani lidhur me fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së konfliktit të interesit. Pas kësaj, përmes komunikimeve dhe

korrespondencave Agjencia ka njoftuar zyrtarin në fjalë me pretendimet për konflikt të interesit dhe faktet që posedon Agjencia lidhur me këtë rast.

I njëjti ka dërguar në Agjenci sqarimet dhe qëndrimet e tij, përfshirë dokumentacionin përkatës, lidhur me pretendimet për konflikt të interesit. Ndër të tjera, z. Bejtullah Destani ka theksuar se, citojmë nga deklaratata e tij:

*"[...] dua të sjell në vëmendje se unë kam dhënë dorëheqjen nga Institutit të Historisë "Ali Hadri" në Prishtinë, dhe nuk ushtror më detyrat në këtë institucion. Po ashtu, [...] për librin me titull: "Mbrojtja e Shkodrës në Luftërat Ballkanike 1912-1913 dokumente osmane" me autor Bejtullah Destani dhe N.B., sjell në vëmendje se ky libër nuk është botuar pasi nuk ka kaluar procesion e recensionit, dhe për këtë arsye nuk mund të konsiderohet si botim i finalizuar. [...] Në lidhje me pretendimin se kam përfutuar fonde për realizimin e botimit apo ushtrimin e detyrave, sjell në vëmendje se në asnjë rast nuk kam përfutuar fonde monetare dhe/ose avantazh të tjera si pasojë e botimit apo pjesëmarrjes në Institutin e Historisë "Ali Hadri" në Prishtinë. Përsa i përket pretendimit se rizgjedhja në detyrën e UD Drejtorit të Institutit të z. Teuta Shala-Peli është bërë me votën time si anëtar i Këshillit Drejtues të Institutit, sjell në vëmendje se në bazë të procedurave të Institutin e Historisë "Ali Hadri" në Prishtinë znj. Teuta është zgjedhur me shumicën e votave kolegjiale të Këshillit Drejtues të Institutit, dhe jo vetëm me votën time. [...] Për sa parashtruar më lart, vlerësoj se nuk gjenden në konflikt të mundshëm të interesit në Institutin e Historisë "Ali Hadri" në Prishtinë."*

Agjencia ka analizuar në mënyrë të gjithanshme informatat dhe dokumentacionin e pranuar nga jashtë, përfshirë informatat që raportuesi i rastit ka paraqitur në takimin e datës 14.02.2023, si dhe deklaratat, sqarimet dhe dokumentacionin e paraqitur nga zyrtarët e lartë znj. Teuta Shala - Peli dhe z. Bejtullah Destani përkitazi me këtë rast, të gjitha këto në kuptim të dispozitave të LPKI-së, dhe më pas ka konstatuar gjendjen faktike si në vijim:

*- Zgjedhja dhe rizgjedhja e znj. Teuta Shala - Peli, u.d. Drejtoreshë e Institutit të Historisë*

Me vendimin e datës 04.07.2022, nr. protokollit 01/82/22, dt. e protokollit 04.08.2022, KD i Institutit të Historisë ka zgjedhë znj. Teuta Shala - Peli, u.d. drejtoreshë të këtij instituti, vendimi (në mungesë të drejtorit/kryesuesit) është nënshkruar nga anëtari i KD-së z. Bejtullah Destani, njëherit kryesues i KD-së për mbledhjen e datës 04.07.2022.

Sipas procesverbalit të mbledhjes së KD të Institutit të Historisë, e mbajtur më datë 04.07.2022, për u.d. drejtor të Institutit të Historisë janë propozuar dy (2) kandidatë, ku për znj. Teuta Shala - Peli kanë votuar tre (3) anëtarë të KD-së (Gj. B., P. K. dhe B. D.), ndërsa për kandidatin tjetër (A. M.) ka votuar një (1) Anëtar i KD-së (A.K.).

Mbajtjes së mbledhjes së KD-së si më lartë dhe vendimit për zgjedhjen e u.d. drejtorit të Institutit të Historisë i ka paraprirë një shkresë e Ministres së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) nr. protokollit 01B/1472, e datës 28.06.2022, me të cilën ka kërkuar nga KD i Institutit të Historisë që në procedurë sipas ligjit dhe statutit të thërret mbledhjen dhe të caktoj u.d. drejtorin e këtij instituti.

Me vendimin e datës 21.12.2022, nr. protokollit 01/164/22, dt. e protokollit 30.12.2022, KD i Institutit të Historisë ka rizgjedhë znj. Teuta Shala - Peli, u.d. drejtoreshë të këtij instituti, vendimi (në mungesë të drejtorit/kryesuesit) është nënshkruar nga Sekretari Shkencor i

Instituti të Historisë, njëherit (sipas statutit) kryesues i KD-së për mbledhjen e datës 21.12.2022.

Sipas procesverbalit të mbledhjes së KD të Instituti të Historisë, e mbajtur më datë 21.12.2022, për u.d. drejtor të këtij instituti është propozuar të rizgjedhet si e vetmja kandidate znj. Teuta Shala - Peli, për rizgjedhjen e të cilës kanë votuar në mënyrë unanime katër (4) anëtarët e KD-së (A. K., Gj. B., B. D. dhe P. K.) dhe Sekretari Shkencor (F. R.), njëherit kryesues i mbledhjes sipas statutit të këtij instituti.

Mbajtjes së mbledhjes si më lartë i kanë paraprirë një sërë komunikimesh elektronike zyrtare ndërmjet anëtarëve të KD-së dhe dhënia e interpretimit ligjor për procedurën e rizgjedhjes së u.d. drejtorit të Instituti të Historisë, nga sekretari i këtij instituti.

Znj. Teuta Shala - Peli si u.d. Drejtoreshë e Instituti të Historisë dhe njëkohësisht Kryesuese e KD-së, nuk ka marrë pjesë në mbledhjen e KD-së të datës 21.12.2022, në të cilën është rizgjedhë u.d. drejtoreshë e Instituti të Historisë, por e njëjta në këtë mbledhje është zëvendësuar sipas statutit të Instituti të Historisë (*ex lege*) nga z. Sekretari Shkencor i këtij instituti.

Rrjedhimisht, znj. Teuta Shala - Peli nuk ka qenë pjesë e diskutimit dhe vendosjes (vendimmarrjes) së KD-së për zgjedhjen e saj u.d. drejtoreshë të Instituti të Historisë.

Procesverbali i mbledhjes së KD-së i datës 21.12.2022, është nënshkruar nga Sekretari i Instituti të Historisë njëherit anëtar i KD-së (procesmbajtësi: A. K.). Ndërkohë, në mbledhjen e radhës së KD-së e datës 28.12.2022, të cilën e ka kryesuar znj. Teuta Shala - Peli, pika e dytë (2) e rendit të ditës ka qenë "Miratimi i procesverbalit nga mbledhja (21.12.2022) e kaluar", me ç'rast KD-ja ka miratuar procesverbalin e mbledhjes së datës 21.12.2022, aprovimin e të cilit e kanë nënshkruar (përveç procesmbajtësit) edhe tre (3) anëtarët tjerë të KD-së, përfshirë edhe znj. Teuta Shala - Peli.

*- Procesi i konkursit nr. protokollit 01/172/23 i datës 03.02.2023, për zgjedhje të drejtorit të Instituti të Historisë, përfshirë anulimin e konkursit paraprak për drejtor të këtij instituti;*

Më datë 05.04.2022, KD i Instituti të Historisë kishte publikuar konkursin për drejtor të këtij instituti, i cili kishte qenë i hapur për aplikim pesëmbëdhjetë (15) ditë nga data e publikimit. Znj. Teuta Shala - Peli në atë kohë nuk kishte qenë u.d. drejtoreshë përkatësisht kryesuese e KD-së së Instituti të Historisë dhe e njëjta nuk kishte aplikuar në këtë konkurs.

Me shkresën nr. protokollit 01B/1008, e datës 11.05.2022, drejtuar KD-së dhe Sekretarit Shkencor të Instituti të Historisë, Ministria e MASHTI ka njoftuar se ka kërkuar nga (atëherë) Agjencia kundër Korrupsionit interpretim për konflikt të mundshëm të interesit në procesin e zgjedhjes së drejtorit të Instituti të Historisë, si dhe ka kërkuar që të pezullohen veprimet procedurale në procesin e rekrutimit (për drejtor) deri në pranimin e përgjigjes nga Agjencia.

Pas përgjigjes së Agjencisë (DPKI-06-01/3781/22, dt. 09.09.2022), Ministria e MASHTI me shkresën nr. protokollit 01B/2548, e datës 30.09.2022, drejtuar KD të Instituti të Historisë, thekson se [...] kjo shkresë duhet të shërbejë si autorizim për të vazhduar me një vlerësim të pajtueshmërisë së konkursit me Ligjin për veprimtari kërkimore shkencore, Statutin e Instituti dhe aktet tjera nënligjore në fuqi të cilat janë bazë për shpalljen e konkursit në sektorin publik.

[...]. Në këtë periudhë kohore znj. Teuta Shala - Peli ka qenë u.d. drejtoreshë njëherit edhe kryesuese e KD të Institutit të Historisë.

Me e-mailin e datës 04.10.2022, znj. Teuta Shala - Peli ka ftuar anëtarët e KD-së për mbledhjen e caktuar për datën 06.10.2022, ku pika e tretë (3) e rendit të ditës është caktuar “Shqyrtimi i shkresës së MASHTI”.

Sipas procesverbalit të mbledhjes së KD të Institutit të Historisë, e mbajtur më datë 06.10.2022, pjesëmarrës kanë qenë znj. Teuta Shala - Peli dhe katër (4) anëtarë tjetër të KD-së (A. K., GJ. B. dhe P.K. - prezent, ndërsa B. D. - përmes linjës telefonike). Pika e tretë e rendit të ditës “Shqyrtimi i shkresës së MASHTI”, pas diskutimeve dhe listimit të “shkeljeve” të konkursit për drejtor të Institutit të Historisë, si dhe pas propozimit të njërit nga anëtarët e KD-së (P.K.) për anulim të këtij konkursi, KD-ja vendosi për anulimin e konkursit në fjalë me tre (3) vota për (Teuta Shala - Peli, P.K. dhe B. D.) një (1) abstenim (Gj. B.) dhe një (1) votë kundër (A.K.).

Si rrjedhojë, me Vendimin e datës 06.10.2022, nr. protokollit I.H. 01/132/22, dt. e protokollit 12.10.2022, KD i Institutit të Historisë ka anuluar konkursin e datës 05.04.2022, i shpallur për drejtor të këtij instituti.

Sipas deklaratës së znj. Teuta Shala - Peli të dhënë në takimin e datës 22.02.2023, deri në anulimin e konkursit si më lartë, vetëm komisioni rekrutues ka qenë i themeluar ndërsa nuk janë shqyrtuar aplikacionet dhe nuk janë ndërmarrë veprime tjera sepse konkursi ishte pezulluar.

Sipas procesverbalit nga mbledhja e KD të Institutit të Historisë, e mbajtur më datë 01.02.2023, pjesëmarrës kanë qenë znj. Teuta Shala - Peli dhe katër (4) anëtarë tjetër të KD-së (A. K., GJ. B. dhe P.K. - prezent, ndërsa B. D. - përmes linjës telefonike). Pika e tretë e rendit të ditës “Marrja e vendimit për shpalljen e konkursit për drejtor të IH-së”, KD-ja pas diskutimeve dhe propozimeve, me votat e të gjithë anëtarëve (unanimisht) vendosi për shpalljen e konkursit për zgjedhjen e drejtorit të Institutit të Historisë.

Më datë 06.02.2023, KD-ja ka shpallë konkursin për zgjedhjen e drejtorit të Institutit të Historisë (nr. protokollit I.H 01/172/23, dt. e protokollit 03.02.2023). Konkursi ka qenë i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë nga data e publikimit.

Me e-mailin e datës 06.02.2023, znj. Teuta Shala - Peli, ka njoftuar organet dhe stafin e Institutit të Historisë se ka konkurruar për pozitën drejtor i këtij instituti sipas konkursit të shpallur më datë 06.02.2023, si dhe ka kërkuar nga Sekretari Shkencor dhe Sekretari i Institutit të Historisë që në përputhje me legjislacionin në fuqi të vazhdohet me procedurat e mëtutjeshme.

Rrjedhimisht, znj. Teuta Shala - Peli ka aplikuar në këtë konkurs pas vendimmarrjes së KD-së për shpallje të konkursit, pjesë e të cilës ka qenë.

Sekretari Shkencor i Institutit të Historisë, pas marrjes së interpretimit ligjor dhe sqarimeve nga Sekretari i Institutit të Historisë, përkritazi me mandatin e tij si zëvendësues sipas Statutit (*ex lege*) i drejtorit përkatësisht kryesuesit të KD-së (komunikimet elektronike e-maillet e datës 06.02.2023), ka caktuar mbledhjen e KSH të Institutit të Historisë për datën 08.02.2023, si dhe

ka njoftuar anëtarët e këtij këshilli për mbledhjen dhe rendin e ditës, ashtu që pika e tretë është paraparë “Emërimi i Komisionit për zbatim të procedurës së zgjedhjes së drejtorit”.

Sipas procesverbalit nga mbledhja e KSH-së e mbajtur më datë 08.02.2023, në këtë mbledhje kanë marrë pjesë shtatëmbëdhjetë (17) anëtarë të KSH-së dhe Sekretari i Institutit të Historisë pa të drejtë vote. Ndërkohë që gjatë diskutimit për pikën e tretë (3) të rendit të ditës, një anëtar i KSH-së (Sh. I.) e ka lëshuar mbledhjen.

Mbledhjen si më lartë e ka kryesuar Sekretari Shkencor i Institutit të Historisë, pasi që i njëjti sipas statutit të këtij instituti (*ex lege*) ka zëvendësuar znj. Teuta Shala - Peli, e cila siç u konstatua më lartë, është tërhequr nga procedurat për konkursin për drejtor sepse e njëjta është pjesëmarrëse në konkurs.

KSH i Institutit të Historisë, pas propozimeve që kanë bërë anëtarët e këtij këshilli, me pesëmbëdhjetë (15) vota për ka aprovuar propozimet për emërimin e komisionit për zbatimin e procedurës së zgjedhjes së drejtorit prej tre (3) anëtarëve (E. K-H. kryetare, O. D. anëtar dhe S. L. anëtar). Votimi si më lartë për secilin anëtarë veç e veç është bërë unanimisht, ngase nga gjashtëmbëdhjetë (16) anëtarë prezent me të drejtë vote të KSH-së, nga pesëmbëdhjetë kanë votuar për propozimet, ndërsa secili anëtarë i propozuar nuk ka votuar për vete.

Znj. Teuta Shala - Peli pas aplikimit të saj për drejtor të Institutit të Historisë, nuk ka marrë pjesë në mbledhjen në të cilën është emëruar komisioni për zbatimin e procedurës për zgjedhje të drejtorit.

Në këtë kontekst, Agjencia në takimin e mbajtur e ka njoftuar zyrtaren e lartë znj. Teuta Shala – Peli për obligimin e saj konform dispozitave të LPKI-së, që deri në përfundimin në tërësi të procesit të zgjedhjes së drejtorit të Institutit të Historisë, duhet të tërhiqet nga vendimmarrja në çdo fazë të këtij procesi. E njëjta ka deklaruar se deklarin dhe tërheqjen që e ka bërë me rastin e aplikimit, do ta zbatoj deri në fund të procesit.

*- Procesi i trajtimit të kërkesës për mbështetje të botimit të librit të z. Bejtullah Destani, (ish) anëtar i KD të Institutit të Historisë nga KSH i këtij instituti*

Me Vendimin nr. 01B/023, i datës 11.02.2022, Ministrja e MASHTI ka emëruar z. Bejtullah Destani anëtar të KD të Institutit të Historisë.

Me shkresën e datës 10.11.2023[2022], z. Bejtullah Destani, ka kërkuar nga u.d. drejtoresha e Institutit të Historisë znj. Teuta Shala - Peli, që në mbledhjen e KSH t'ua paraqes anëtarëve të këtij këshilli kërkesën për botimin e librit me dokumente “Mbrojtja e Shkodrës në luftërat ballkanike 1912 - 1913 - dokumente osmane”, më autorë N. B. dhe Bejtullah Destani.

Sipas procesverbalit të mbledhjes së KSH të Institutit të Historisë e mbajtur më datë 25.11.2022, të cilën (sipas statutit) e ka thirrë dhe kryesuar znj. Teuta Shala - Peli, në pikën e katërt (4) të rendit të ditës “shqyrtimi i kërkesave për botime”, përveç kërkesave tjera për botime, është trajtuar edhe kërkesa e z. Bejtullah Destani.

Sipas procesverbalit të sipërpërmendur, konstatohet se është ngritë çështja e konfliktit të mundshëm të interesit për kërkesën e z. Bejtullah Destani, mirëpo sekretari i Institutit të Historisë sipas kërkesës së anëtarëve të KSH-së ka dhënë interpretimin se, *në këtë rast nuk ka*

*konflikt të interesit sepse z. Bejtullah Destani si anëtar i KD-së, nuk ka çasje në vendimmarrje në KSH.*

KSH-ja ka caktuar recensentët (F. R. dhe M. O.) për kërkesën e z. Bejtullah Destani, me pesëmbëdhjetë (15) vota për dhe një (1) kundër. Lidhur me kërkesën në fjalë ka votuar edhe znj. Teuta Shala - Peli. Për më tepër, sipas procesverbalit nga mbledhja e KSH-së e datës 25.11.2022, rezultoi se nuk është marrë vendim përfundimtar për mbështetjen e botimit të librit dhe/apo ndarje të mjeteve financiare për botim, por vetëm për caktimin e recensentëve për vlerësim të librit.

Më datë 19.12.2022, recensentët (F. R. dhe M. O.) kanë paraqitur tek u.d. drejtoresha e Institutit të Historisë znj. Teuta Shala - Peli, recensionin e tyre për kërkesën si më lartë, me ç'rast kanë paraqitur vlerësimin e tyre për materialin duke dhënë disa vërejtje dhe sugjerime me rekomandimin që të njëjtat të shqyrtohen dhe plotësohen para botimit.

Më pas, znj. Teuta Shala - Peli, me e-mailin e datës 23.12.2022, ka dërguar tek autorët e librit recensionin me rekomandimet e recensentëve. Pranimin e recensionit e ka konfirmuar njëri nga autorët (N. B.) me e-mailin e datës 23.12.2022. Sipas deklaratës së znj. Teuta Shala - Peli, kjo çështje ka mbetur në këtë fazë dhe pas e-mailit të datës 23.12.2022, autorët (deri më tani) nuk kanë paraqitur në Institutin e Historisë materialin e korigjuar sipas rekomandimeve të recensentëve dhe nuk shprehë gatishmëri për të vazhduar.

Rrjedhimisht, deri më tani zyrtari i lartë publik z. Bejtullah Destani, si njëri nga (bashk)autorët e librit për publikimin e të cilit kanë kërkuar nga Instituti i Historisë mbështetje, nuk ka përfituar (botimin e librit) nga institucioni ku ka ushtruar funksionin publik si anëtarë i KD-së të këtij institucioni. Sipas deklaratës së tij, ky libër nuk është botuar pasi nuk ka kaluar procesin e recensionit.

Ndërkohë, z. Bejtullah Destani me shkresën e datës 17.02.2023, drejtuar Ministres së MASHTI, ka parashtruar kërkesën për dorëheqje të parevokueshme nga KD i Institutit të Historisë. Shkresën e ka përcjellë edhe tek u.d. drejtoresha e Institutit të Historisë dhe tek anëtarët tjerë të KD-së, kështu që i njëjti nuk ushtron më detyrat në këtë institucion.

Andaj, në vështrim të gjendjes faktike si më lartë, Agjencia konstatoi si në dispozitiv të këtij opinionin duke u bazuar në dispozitat e nenit 6 lidhur me nenin 17, si dhe nenet 9, 11, 13, 16 dhe 19 të LPKI-së.

Konflikti i interesit është i lidhur ngusht me *vendimmarrjen* e zyrtarit në një çështje të caktuar, në të cilën zyrtari ka apo mund të ketë *interes privat* për vete apo të *personave të afërm*. Kështu, me nenin 6 të LPKI-së është përkufizuar nocioni i konfliktit të interesit, ashtu që: "*Konflikti i interesit lind nga një rrethanë në të cilën zyrtari ka interes privat, që ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare*", ndërsa me dispozitën e nenit 17 [Deklarimi rast për rast i interesave private të zyrtarit], paragrafi 1 të LPKI-së është përcaktuar se: "*Çdo zyrtar gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vetëdeklarimin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij privat ose të personave të afërm me të lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhet shkak për lindjen e një konflikti të interesit dhe të tërhiqet nga kjo vendimmarrje.*"

... lidhur me nenin 3 paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të LPKI-së, me të cilin është përkufizuar se: *“interesi privat i personit zyrtar - nënkupton çfarëdo përparësie për personin zyrtar, familjen e tij, të afërmit, miqtë dhe personat apo organizatat me të cilat ai ka pasur apo ka marrëdhënie afariste”,* si dhe me nënparagrafin 1.6 të këtij nenin me të cilin është përkufizuar se: *“person i afërm me zyrtarin është – bashkëshorti ose personi që bashkëjeton, të afërmit në vijë të drejtë të gjakut pa kufizime, të afërmit në vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt, adoptuesi, i adoptuari, i afërmi në gjini të krushqisë deri në shkallën e dytë si dhe çdo person fizik apo juridik i cili ka pasur ose ka një lidhje të përbashkët interesi privat pasuror ose jopasuror me zyrtarin [...].”*

Dispozita e nenit 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.12 të LPKI-së, e definojnë nocionin vendimmarrje si: *“çasti i fundit i procesit vendimmarrës gjatë të cilit vendoset përmbajtja përfundimtare e aktit apo kontratës si dhe ato çaste paraprake të vendimmarrjes të cilat janë thelbësore dhe përcaktuese në të cilat pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i zyrtarit përcaktojnë përmbajtjen përfundimtare të aktit apo kontratës si dhe çdo veprim i zyrtarit në ushtrimin e funksionit publik.”*

Me nenin 19 [Masat për parandalimin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesave], paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, të LPKI-së është përcaktuar se: *“1. Në ushtrimin e funksionit publik, zyrtari sipas rastit dhe rrethanave: [...] 1.2. merr masa për vetëpërgjashimin ose përjashtimin paraprak nga procesi i vendimmarrjes, diskutimit dhe votimit të çështjes në konflikt me përjashtim të rasteve të përcaktuara shprehimisht me ligj.”*

Në kuptim të dispozitave si më lartë, Agjencia ka konstatuar se pjesëmarrja dhe votimi i z. Bejtullah Destani, në mbledhjet e KD të datës 04.07.2022 dhe 21.12.2022, për zgjedhjen dhe rizgjedhjen e znj. Teuta Shala - Peli u.d. drejtoreshë e Institutit të Historisë, mandej në mbledhjet e KD të datës 06.10.2022 për anulimin e konkursit të datës 05.04.2022, dhe atë të datës 01.02.2023, për shpalljen e konkursit për drejtor të Institutit të Historisë, nuk paraqet konflikt të interesit.

Kjo për faktin se, së pari, nuk është gjetur dhe vërtetuar që z. Bejtullah Destani të ketë pasur interes privat për çështjet në të cilat ka marrë pjesë, kurse pjesëmarrja dhe votimi i tij për proceset si më lartë kanë qenë në funksion të detyrave dhe përgjegjësisive të tij si anëtar i KD-së. Së dyti, z. Bejtullah Destani dhe znj. Teuta Shala - Peli nuk konsiderohen persona të afërm në kuptim të dispozitës së nenit 3 paragrafi 1, nënparagrafi 1.6 të LPKI-së, sepse raporti anëtar i KD-së - u.d. drejtor përkatësisht kryesues i KD të Institutit të Historisë, nuk është raport që cilësohet si *“person i afërm me zyrtarin”* sipas dispozitës në fjalë.

Agjencia ka trajtuar rolin e znj. Teuta Shala – Peli në proceset për zgjedhjen dhe rizgjedhjen e saj në pozitën u.d. drejtoreshë e Institutit të Historisë, por ka konstatuar se në asnjërin rast nuk ka pasur situatë të konfliktit të interesit.

Kështu, me rastin e zgjedhjes u.d. drejtoreshë e Institutit të Historisë, e njëjta nuk ka qenë fare pjesë e KD-së dhe rrjedhimisht nuk ka pasur mundësi për përfshirje në vendimmarrje, ndërsa me rastin e rizgjedhjes së saj, edhe pse ka qenë u.d. drejtoreshë e Institutit të Historisë dhe njëkohësisht kryesuese e KD-së, nuk ka marrë pjesë në mbledhjen e KD-së të datës 21.12.2022, në të cilën është rizgjedhë, sepse e njëjta në këtë mbledhje është zëvendësuar sipas statutit të Institutit të Historisë (*ex lege*) nga z. Sekretari Shkencor i këtij instituti.



Rrjedhimisht, znj. Teuta Shala - Peli nuk ka qenë pjesë e diskutimit dhe vendosjes (vendimmarrjes) së KD-së për zgjedhjen e saj u.d. drejtoreshë të Institutit të Historisë, kështu që duke marrë masat sipas dispozitës së sipërcituar të nenit 19 të LPKI-së, ka shmangur situatën e mundshme të konfliktit të interesit në kuptim të dispozitave të LPKI-së.

Agjencia ka pasur parasysh se në mbledhjen e KD-së të datës 28.12.2022, të cilën e ka kryesuar znj. Teuta Shala - Peli, pika e dytë (2) e rendit të ditës ka qenë “Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar (21.12.2022)”, me ç’rast KD ka miratuar procesverbalin e mbledhjes së datës 21.12.2022, aprovimin e të cilit e kanë nënshkruar (përveç procesmbajtësit) edhe tre (3) anëtarët tjerë të KD-së, përfshirë edhe znj. Teuta Shala – Peli, por nënshkrimi i aprovimit të procesverbalit të mbledhjes (të kaluar) së KD-së e datës 21.12.2022, nga znj. Teuta Shala - Peli, në mbledhjen (e radhës) e KD-së të datës 28.12.2022, nuk nënkupton pjesëmarrje të saj në vendimmarrje për rizgjedhje si u.d. drejtoreshë e Institutit të Historisë, sepse nga procesverbali i mbledhjes së KD-së e datës 21.12.2022, është e qartë se znj. Teuta Shala - Peli nuk ka qenë pjesë e kësaj mbledhje por është zëvendësuar nga Sekretari Shkencor sipas statutit.

Sa i përket pjesëmarrjes dhe votimit të znj. Teuta Shala – Peli në mbledhjen e datës 01.02.2023, në të cilën e KD me votat e të gjithë anëtarëve (unanimisht) vendosi për shpalljen e konkursit për zgjedhjen e drejtorit të Institutit të Historisë, Agjencia ka konstatuar se një situatë e tillë nuk është konflikt interesi sipas dispozitave të LPKI-së, pasi që aplikimi i saj në këtë konkurs ka ndodhë pas shpalljes së konkursit. Ndërsa pas aplikimit e njëjta është tërhequr nga pjesëmarrja në procesin e zgjedhjes së drejtorit, përkatësisht nuk ka marrë pjesë në mbledhjen e KSH-së në të cilën është bërë emërimi i komisionit për zbatim të procedurës së zgjedhjes së drejtorit, pasi që sipas statutit (*ex lege*) është zëvendësuar nga Sekretari Shkencor i Institutit të Historisë. Në këtë mënyrë, znj. Teuta Shala – Peli ka shmangur situatën e mundshme të konfliktit të interesit në kuptim të dispozitave të LPKI-së.

Ndërsa, sa i përket pjesëmarrjes dhe votimit të znj. Teuta Shala – Peli në mbledhjen e KD-së e datës 06.10.2022, në të cilën është vendosë për anulimin e konkursit për drejtor të Institutit të Historisë të datës 05.04.2022, dhe pretendimit se kjo vendimmarrje lidhet me krijimin e mundësisë për zgjedhjen e saj në pozitën e drejtorit sipas konkursit të datës 01.02.2023, Agjencia nuk ka gjetur dhe vërtetuar se nga votimi (vendimmarrja) i saj për anulimin e këtij konkursi të ketë pasur çfarëdo përfitimi (interesi privat), në procesin e zgjedhjes së drejtorit sipas konkursit aktual. Aq më tepër kur një vendimmarrje e tillë ka ardhur si rezultat i shkresës së Ministres së MASHTI dhe pas konstatimit të shkeljeve në këtë konkurs nga ana e KD-së, ndërsa vota e saj nuk ka qenë përcaktuese për rezultatin e votimit nga KD as për anulimin e konkursit të kaluar e as për shpalljen e konkursit aktual.

Përkritazi me procesin e trajtimit të kërkesës për mbështetje të botimit të librit të z. Bejtullah Destani, (atëherë) anëtar i KD të Institutit të Historisë, Agjencia ka konstatuar se pjesëmarrja dhe votimi i znj. Teuta Shala – Peli në mbledhjen e KSH të Institutit të Historisë e mbajtur më datë 25.11.2022, në të cilën me pesëmbëdhjetë (15) vota për dhe një (1) kundër, janë caktuar recensentët për kërkesën e z. Bejtullah Destani, nuk paraqet situatë të konfliktit të interesit.

Sepse së pari, nuk është gjetur dhe vërtetuar që znj. Teuta Shala - Peli të ketë pasur interes privat për çështjen si më lartë, kurse pjesëmarrja dhe votimi i saj për këtë çështje ka qenë në funksion të realizimit të detyrave dhe përgjegjësisë të saj si kryesuese me të drejtë vote e KSH. Për më tepër, nuk janë vërtetuar pretendimet se vendimmarrja e znj. Teuta Shala – Peli lidhur

me kërkesën e z. Bejtullah Destani për mbështetje të botimit të librit dhe vendimmarrjet e z. Bejtullah Destani për: zgjedhjen dhe rizgjedhjen e znj. Teuta Shala - Peli u.d. drejtoreshë e Institutit të Historisë; anulimin e konkursit të datës 05.04.2022 dhe shpalljen e konkursit për drejtor të Institutit të Historisë, të kenë qenë të ndërlidhura dhe të kushtëzuara me njëra-tjetrën.

Së dyti, siç është theksuar edhe më lartë, znj. Teuta Shala – Peli dhe z. Bejtullah Destani nuk konsiderohen persona të afërm në kuptim të dispozitës së nenit 3 paragrafi 1, nënparagrafi 1.6 të LPKI-së, sepse raporti u.d. drejtor përkatësisht kryesues i KD-së të Institutit të Historisë - anëtar i KD-së, nuk është raport që cilësohet si “*person i afërm me zyrtarin*” sipas dispozitës në fjalë.

Vështruar si proces, trajtimi i kërkesës për mbështetje të botimit të librit të z. Bejtullah Destani, nga KSH, apriori nuk paraqet konflikt të interesit, aq më tepër kur nuk është marrë ndonjë vendim përfundimtar për mbështetjen e botimit të librit dhe/apo ndarje të mjeteve financiare për botim, pasi që libri nuk e ka kaluar recensionin.

Megjithatë, meqenëse zyrtari i lartë z. Bejtullah Destani në kohën e trajtimit të kërkesës nga KSH, ka qenë anëtar i KD të Institutit të Historisë, Agjencia e ka trajtuar këtë çështje edhe nga këndvështrimi i ndalesave të përcaktuara me LPKI, përkatësisht nëse zyrtari i lartë (në këtë rast z. Bejtullah Destani) mund të përfitoj ndihmë nga institucioni ku ushtron funksionin publik (në këtë rast Instituti i Historisë).

Kësisoj, Agjencia vlerëson se përfitimi eventual nga z. Bejtullah Destani i mbështetjes për botimin e librit nga Instituti i Historisë, në të cilin ka ushtruar detyra publike, do të binte ndesh me nenin 13 paragrafi 3 të LPKI-së, me të cilin është përcaktuar se: *“Personat e përmendur [zyrtari i lartë] në paragrafët 1. dhe 2. të këtij neni, [...] nuk kanë të drejtë të lidhin kontratë ose të përfitojnë ndihmë nga institucionet qendrore ose lokale, në të cilat zyrtari i lartë ushtron detyra publike.”* Kjo ndalesë, nuk ka të bëjë me vendimmarrjen e KSH-së për çështjen në fjalë, e as për pjesëmarrjen e znj. Teuta Shala – Peli në këtë vendimmarrje, por me faktin se z. Bejtullah Destani, si zyrtar i lartë që ushtron funksionin e anëtarit të KD të Institutit të Historisë, sipas dispozitës së sipërcituar, nuk ka të drejtë të përfitoj ndihmë (mbështetje për botim të librit) nga ky institucion.

Përveç kësaj, tani që z. Bejtullah Destani ka dhënë dorëheqje nga KD i Institutit të Historisë, duhet të ketë në konsideratë kufizimet e përcaktuara me nenin 18 [Kufizimet e zyrtarit të lartë pas përfundimit të ushtrimit të detyrës publike], të LPKI-së, sidomos paragrafin 1, nënparagrafin 1.2, me të cilin është përcaktuar se: *“1. Zyrtari i lartë nuk ka të drejtë: [...] 1.2. të përfshihet në marrëdhënie kontraktore, drejtpërdrejt ose nëpërmjet ndonjë personi të afërm ose të besuar, me institucionin ku ka ushtruar funksionin publik për një periudhë deri në dy (2) vjet pas përfundimit të funksionit publik”.*

Agjencia sikur secilin pretendim që është ngritur për konflikt të interesit për çështjet si më lartë, ka trajtuar edhe pretendimet lidhur me përbërjen e komisionit për zbatimin e konkursit për drejtor të Institutit të Historisë dhe lidhjeve të pretenduara të anëtarëve të këtij komisioni me znj. Teuta Shala – Peli, përfshirë edhe pretendimet për “favorizimin” e tyre apo familjarëve të tyre dhe anëtarëve të KSH nga ana e znj. Teuta Shala – Peli, në “këmbim” të, siç është pretenduar, marrjes së votës së tyre për zgjedhje drejtoreshë e Institutit të Historisë, duke iu referuar shkeljes së disa dispozitave të nenit 9, nenit 11 dhe nenit 16 të LPKI-së. Mirëpo nga

sa është konstatuar më lartë, komisioni në fjalë është propozuar dhe është emëruar unanimisht me votat e të gjithë anëtarëve të KSH-së prezent me të drejtë vote, ndërsa nuk është gjetur dhe vërtetuar që znj. Teuta Shala – Peli të ketë kryer ndonjë veprim të ndaluar në kuptim të nenit 9 të LPKI-së. Kurse neni 11 [Punët e ndaluara për zyrtarin] i LPKI-së nuk ka të bëjë me situatat e pretenduara dhe të trajtuara.

Ndërsa, sa i përket referimit të nenit 16 të LPKI-së dhe pretendimeve për ushtrim të ndikimit nga ana e znj. Teuta Shala – Peli, Agjencia në kuptim të dispozitave të nenit 16 [Tentimi dhe ndikimi në vullnetin e zyrtarit] të LPKI-së, me të cilin është paraparë se:

*1. Nëse ekziston tentimi i ndikimit në vullnetin e tij, zyrtari duhet ta lajmërojë me shkrim dhe të konsultohet me udhëheqësin apo institucionin udhëheqës të organit që e ka zgjedhur apo emëruar në mënyrë që të shmang çdo ndikim në vullnetin e tij.*

*2. Nëse ndaj zyrtarit gjatë dhe lidhur me ushtrimin e funksionit publik ushtrohet ndikim i drejtpërdrejtë apo i tërthortë, haptazi apo në mënyrë anonime për të votuar apo për të marrë vendim konkret, zyrtari e njofton me shkrim institucionin që e ka zgjedhur apo emëruar si dhe Agjencinë e cila pas shqyrtimit do të vendosë nëse ekziston një bazë e arsyeshme që të lajmërohen organet e ndjekjes.*

*3. Në rast tentimi apo ushtrimi të ndikimit për ta ndryshuar vullnetin e tij, zyrtari duhet: 3.1. të refuzojë ofertën; 3.2. të përpiqet të identifikojë ofertuesin nëse oferta është anonime dhe shkaqet ose interesat e mundshme; 3.3. nëse është fjala për dhuratë e cila për shkak të rrethanave nuk mund të kthehet, zyrtari duhet menjëherë ta njoftojë me shkrim dhe ta dorëzojë dhuratën te udhëheqësi mundësisht sa më shpejt dhe jo më vonë se pesë (5) ditë; 3.4. të tregojë dëshmitarët e ndodhisë nëse kjo është e mundur.*

*4. Nëse konstatohet se votimi dhe vendimi është marrë në kundërshtim me paragrafin 3. të këtij neni ai shpallet i pavlefshëm nga institucioni përkatës.*

... nga procesverbalet e mbledhjeve të KD-së dhe KSH-së në të cilat është vendosur për çështjet e trajtuara më lartë, si dhe nga shkresat tjera të lëndës, nuk është gjetur që në kuptim të dispozitave të sipërcituara ndonjë anëtar i këtyre organeve apo ndonjë zyrtar tjetër i përfshirë në këto procese, të këtë lajmëruar (njoftuar me shkrim) ndonjë rast të tentimit apo ushtrimit të ndikimit, tek udhëheqësi apo institucioni që e ka zgjedhë apo emëruar, dhe se Agjencia deri më tani nuk ka pranuar asnjë njoftim të tillë.

Në këtë kontekst, Agjencia rekomandon secilin nga trupat (organet) vendimmarrëse në procesin e zgjedhjes së drejtorit të Institutit të Historisë, që në kuptim të nenit 16 të LPKI-së ta raportojnë (njoftojnë me shkrim) çdo tentim apo ushtrim ndikimi për vendimmarrjen e tyre në këtë proces.

Gjithashtu, trupat (organet) vendimmarrëse në procesin e zgjedhjes së drejtorit të Institutit të Historisë, duhet të kenë parasysh dispozitën e nenit 7, paragrafi 3, të LPKI-së, me të cilën është përcaktuar se: “Personi që ofron informata të bazuara për rastet e konfliktit të interesit gëzon mbrojtje në pajtim me ligjin”, dhe dispozitën e nenit 9, paragrafi 1, nënparagrafi 1.12 të LPKI-së, e cila parashih se: “1. Gjatë ushtrimit të funksionit publik zyrtarit i ndalohen këto veprime: [...]; 1.12. të ndër marrë veprime me efekte ndëshkuese apo të bëhet pengesë për fitimin e të drejtave të ligjshme të zyrtarëve apo subjekteve që ofrojnë informata për raste të konfliktit të

*interesit të zyrtarit, personave të lidhur me të ose personave të besuar për këtë shkak*”, lidhur me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-085 për mbrojtjen e sinjalizuesve.

Agjencia ka trajtuar pretendimet e parashtruara vetëm në kontekst të situatave të mundshme të konfliktit të interesit, ndërsa pretendimet tjera lidhur me (pa)rregullsinë e proceseve për zgjedhjen e (u.d.) drejtorit të Institutit të Historisë, mandej pretendime për shkeljen e dispozitave dhe procedurave të brendshme të përcaktuara me legjislacionin për Institutin e Historisë, pretendime për mandatin e anëtarëve të KD të Institutit të Historisë, ato për keqpërdorim të detyrës zyrtare, si dhe shumë pretendime tjera që janë jashtë sferës së konfliktit të interesit, përkatësisht jashtë mandatit dhe kompetencave ligjore të Agjencisë, të trajtohen dhe zgjidhen brenda Institutit të Historisë apo mekanizmave e institucioneve tjera kompetente.

Dispozitat e LPKI-së nuk mëtojnë që të kufizojnë apo pengojnë ushtrimin e funksioneve publike, përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësisive ligjore dhe kushtetuese në institucione publike, por përkundrazi, njëri ndër qëllimet e rëndësishme të këtij ligji është funksionimi i institucioneve publike përmes parandalimit të shfrytëzimit të funksionit publik për interesa private, përkatësisht parandalimit të situatave të konfliktit të interesit, duke mbrojtur kështu interesin publik, ruajtur kredibilitetin dhe imazhin e institucioneve publike.

Ky opinion i referohet vetëm situatës konkrete për konflikt të interesit sipas dispozitave të LPKI-së dhe nuk trajton çështje tjera.

Agjencia ju falënderon për bashkëpunimin.

Me respekt!